

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Krimeve të Rënda, në trupin gjykues, të përbërë nga gjyqtarët Afrim Shala, kryetar i trupit gjykues, Lulejta Shabani dhe Ramush Ademi, anëtarë të trupit gjykues, me sekretaren juridike Hyrije Sylejmani, në çështjen penale ndaj të akuzuarit B. M., nga F., të cilin sipas autorizimit e mbron avokati A. S., nga Gj. dhe ndaj të akuzuarit I. Sh., nga F., të cilin sipas autorizimit e mbron avokati A. I., nga F., për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës ose autoritetit zyrtar, nga neni 422 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës,<sup>1</sup> sipas aktakuzës së Prokurorisë Publike të Qarkut në Gj., PP.I.nr.82/2012, e datës 07.05.2012, të cilën e përfaqësonte prokurori A. U., pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 19.06.2014, mori dhe publikisht shpalli këtë :

## AKTGJYKIM

## I.

I akuzuari B. M., nga babai Sh. dhe nëna A., e lindur A., i lindur më ..., në F., kur edhe tani jeton, rr.”...”, p.n., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i tre fëmijëve, i papunë, i gjendjes së varfur ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, më parë nuk ka qenë i dënuar për vepra tjera penale,

## ËSHTË FAJTOR

Me datën 08.04.2012, rreth orës 16:30 minuta, në Gj., në B. P. të B., përballë “...”, i akuzuari B. M., me dashje direkte dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete i njëjti shpërdoron pozitën e tij zyrtare, veprimet të cilat i janë besuar lidhur me transportin e parave, ashtu që gjatë transportimit të parave në shumën prej 69.700 Euro, në vend se paratë ti vendosë-dorëzojë në “B. P. të B.” në Gj., me paketim të bllombuar, fillimisht i

<sup>1</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejme KPRK), nr.04/L-082, i datës 20.04.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

njëti çantën ku kanë qenë të deponuara sasia e parave, e takon L. A. i cili kishte huazuar veturën për të marrë ujë tek “B. e D.” dhe deri sa i njëti ndalët për të pirë kafe te Restorant “...”, takohet me dy të akuzuarit dhe fillimisht i akuzuari B. e vendos çantën e bllobuar më parë në veturën e markës “...”, me ngjyrë hiri, me targa të regjistrimit ..., pronë e të akuzuarit B. M., duke e sugjeruar që ta dërgojë në F., me arsyetim se ka dokumentacion zyrtar, në mënyrë që më pas i njëti kur të kthehet do ta merr çantën të cilin L. A. nuk e kishte ditur se çka ka brenda, ashtu që të njëjtit nisen në drejtim të Gj. nga Restorant “...i” dhe ofrohen afër “B. P. të B.”, derisa i akuzuari B., hynë në korridorin e banesave ku është vendosur banka në gjatësi prej 10 metrave, rrëzohet shkallëve duke e njoftuar të akuzuarin I., se ma grabitën çantën dy persona, ndërsa i akuzuari I., qëndron në furgon, duke paraqitur kështu rastin grabitje të parave për shumën e lartcekur edhe pse i njëti ka qenë nën vëzhgim të kamerave të bankës, ashtu që pas punës operative të pjesëtarëve të policisë, të njëjtit arrestohen dhe paratë gjinden dhe konfiskohen në lokalin ku çantën e kishte lënë L. A.,

- me këtë ka kryer veprë penale keqpërdorimi i pozitës ose autoritetit zyrtar, nga neni 422 paragrafi 1 të KPRK.

Andaj, trupi gjykues në bazë të dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 42, 43, 45, 73 dhe 74 të KPRK, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale,<sup>2</sup> të akuzuarit B. M., i shqipton :

## DËNIM ME BURGIM

Ashtu që të akuzuarit B. M., i caktohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muajve, të cilin dënim i akuzuari do ta mbajë pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Koha e kaluar në paraburgim prej datës 08.04.2012 deri më datën 08.05.2012, të akuzuarit B. M., do t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

Detyrohet i akuzuari që ta paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 50 €, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

## II.

---

<sup>2</sup> Kodi i Procedurës Penale (Në tekstin e mëtejshme KPP), nr.04/L-123, i datës 13.12.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

I akuzuari I. SH., nga babai R. dhe nëna S., e lindur Sh., i lindur më ..., në F., ku edhe jeton, rr.”...”, nr...., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i tre fëmijëve, i papunë, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale, me konform neni 364 nënparagrafi 3 të KPP,

## LIROHET NGA AKUZA

Sepse me këtë kishte për të kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës ose autoritetit zyrtar, nga neni 422 paragrafi 1 të KPRK, të përshkruar në dispozitivin I të këtij aktgjykimi.

Shpenzimet e procedurës sa i përket të akuzuarit I. Sh., paguhen nga mjetet buxhetore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

## ARSYETIMI

### 1. Historiku i procedurës dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria e Qarkut në Gjilan, më datës 07.05.2013 ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të akuzuarve B. M. dhe I. M., që të dy nga F., për shkak të veprës penale shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit, nga neni 339 paragrafi 3 lidhur me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës,<sup>3</sup> kurse ndaj të akuzuarit B. M., edhe për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontrollë, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328 paragrafi 2 të KPK.

Pas mbajtjes së seancës, më datën 25.05.2012, gjyqtari për konfirmimin e aktakuzës e ka konfirmuar aktakuzën e lartcekur.

Duke u bazuar në Ligjin për Amnistinë,<sup>4</sup> kryetari i trupit gjykues më datën 25.12.2013, e ka hudhur aktakuzën e lartcekur ndaj të akuzuarit B. M., vetëm sa i përket veprës penale për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontrollë, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328 paragrafi 2 të KPK dhe e ka pushuar procedurën penale për këtë vepër penale, ngase e njëjta është përfshirë në amnisti. Gjithashtu, me këtë aktvendim edhe është konfiksuar arma të cilin i akuzuari B. M., e ka poseduar paautorizim.

---

<sup>3</sup> Kodi i Penal i Kosovës (Në tekstin e mëtejme KPK) - Rregullorja e UNMIK-ut, nr.25/2003, e datës 06.07.2003.

<sup>4</sup> Ligji nr.04/L-209 për Amnistinë, i datës 11.07.20013.

Meqë në këtë çështje penale ishte konfirmuar aktakuza nga ana e gjyqtarit për konfirmimin e aktakuzës, kryetari i trupit gjykues duke ju referuar edhe Letër qarkores së Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës<sup>5</sup> e ka caktuar drejtpërdrejt shqyrtimin gjyqësor, pa patur nevojë që të caktohet shqyrtimi fillestar dhe shqyrtimi i dytë.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, të datës 28.01.2014, prokurori A. U., prokuror në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurisë Themelore në Gj., ka bërë ndryshimin e aktakuzës, duke bërë ndryshime si te përshkrimi i veprimeve inkriminuese, ashtu edhe te kualifikimi ligjor i vepër penale, ku me këtë rast të akuzuarit B. M. dhe I. Sh., i akuzon për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës ose autoritetit zyrtar, nga neni 422 paragrafi 1 të KPRK.

Gjatë fjalës përfundimtare, prokurori Agron Uka, ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës së paraqitur me shkrim dhe të ndryshuar gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke i ka propozuar trupit gjykues që të akuzuarit B. M. dhe I. Sh., t'i shpall fajtor për kryerjen e kësaj vepre penale dhe t'i dënojë sipas ligjit.

I akuzuari B. M. dhe mbrojtësi i tij, avokati A. S. gjatë fjalës përfundimtare i kanë propozuar trupit gjykues që nëse nuk merr aktgjykim lirues, atëherë ndaj të akuzuarit të shqiptojë një dënim të kushtëzuar.

I akuzuari I. Sh. dhe mbrojtësi i tij, avokati A. I., gjatë fjalës përfundimtare i kanë propozuar trupit gjykues që i akuzuari I. Sh. të lirohet nga akuza.

## 2. Pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit B. M.

Në fillim të shqyrtimit gjyqësor, pas ndryshimeve të bëra në aktakuzë nga ana e prokurorit të shtetit, i akuzuari B. M., ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, duke shtuar se e pranojë fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale.

Trupi gjykues, pas dëgjimit të palëve dhe të mbrojtësit të të akuzuarit, ka marrë aktvendim për pranimin e fajësisë, ngase ka ardhur në përfundim se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, avokatin A. S.; se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

## 3. Provat e administruara gjatë shqyrtimeve gjyqësore

---

<sup>5</sup> Letër qarkorja e Gjykatës Supreme e Republikës së Kosovës, GJ.A-SU.A.321/13 e datës 26.04.2013.

Meqë i akuzuari B. M., e ka pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, duke u bazuar në nenin 326 paragrafi 5 të KPP, administrimi i provave ka vazhduar vetëm për të akuzuarin I. Sh., i cili nuk e ka pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet. Duke u bazuar në këtë, trupi gjykues gjatë shqyrtimit gjyqësor i ka administruar këto prova :

- dëgjimin e dëshmitarëve L. A. dhe F. R.;
- provat materiale, siç janë : video incizimet e kamerave të bankës; raportin mjekësor; raporti i shpejtë i Policisë së Kosovës; raporti i vendit të ngjarjes i Policisë së Kosovës; vërtetimi mbi sendet e sekuestruara; fotografitë që gjenden në shkresa të lëndës; formulari i pronës dhe vërtetimi mbi pagesat e gatshme, si dhe
- marrjen në pyetje të akuzuarit I. Sh..

### 3.1. Deklaratat e dëshmitarëve

3.1.1. Dëshmitari L. A., gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se është e vërtetë se dhe më parë kam dhen deklaratë te prokurori dhe është e vërtetë se ditën kritike e kam takuar vetëm të akuzuarin B. M., por jo I. Sh.. Ditën kritike kur unë kam shkuar me mbush ujë te “...” pasi që kam mbushur ujë, jam ndalur dhe kam pirë kafe tek restorant “...” ku e kam takuar një vëlla të shokut tim. Pasi që e kam pirë kafën kam dalë jashtë dhe në parkingun e këtij restoranti unë e kam takuar B. M.n, ku i njëjti e kishte patur një çantë dhe më tha :”mbaje se e kam me dokumente e vi e marr tek lokali”, mandej unë e kam marrë çantën dhe kam vazhduar për F.. Çanta ishte një çantë e thjesht dhe kur kam arrit në F. çantën e kam lënë në lokal timin. Pas kësaj, unë kam shkuar në shtëpi dhe kam qëndruar diku deri në ora 23;45 minuta pasi që veç e kisha shikuar lojën e futbollit në mes të “Realit dhe një ekipi tjetër” ku veç desha të shkoj për të fjetur, atëherë më kanë ftuar me telefon mobil policia e cila ka kërkuar që të shkoj tek lokali im. Unë së pari kam shkuar te garazhi ku policia mi kërkuan çelësat e veturës dhe më thanë se ku janë paratë. Unë i thash se për çfarë para po flisni, ndërsa të njëjtit më kanë pyetur se ku e ke lënë çantën që ta ka dhënë B. M., ndërsa unë i thash se po e kam në lokal. Pastaj, ne kemi shkuar me policinë në lokal ku e kemi marrë çantën dhe jemi nisur për në Gj., pastaj më kanë arrestuar mua, ndërsa të akuzuarit veç kishin qenë të arrestuar në Gj.

Kur ne kemi biseduar në parkingun e restorant “...” me të akuzuarin B. distanca ka qenë shumë e vogël 1 metër. Vetura “...”, ka qenë pronë e B. M.t dhe arsyeja pse unë e kam marrë veturën e të akuzuarit B. M.t ka qenë se unë nuk kam pasur veturë time. Unë nuk kam mundur ta vërejë ndonjë person tjetër me B. M.n, përkatësisht unë nuk e kam parë nëse B. M. ka qenë me ndonjë person

tjetër, ngase unë vetëm kur e kam parë papritmas të njëjtin. Pasi që B. ma ka dhënë çantën i njëjti ka shkuar, ndërsa unë kam filluar të shkoj në F., ngase ka qenë një shi i madh. Unë nuk e kam parë se ku ka shkuar dhe me çka ka shkuar i akuzuari B. M. dhe nuk kam biseduar më gjerësisht me të njëjtin. Meqë me B. M. ne jemi njohur edhe më parë dhe kemi pirë kafe me to dhe kjo ka qenë arsyeja që i njëjti të ma ketë dhënë veturën ditën kritike. Çantën të cilën ma dha mua i akuzuari B. unë e kam vendosur në karrigen e parë. Unë edhe më parë e kam marrë veturën e të akuzuarit B. dhe gjithashtu edhe B. e ka marrë veturën time, mirëpo ditën kritike veturën time e kanë marrë prindërit e mi dhe shoqja ime, ku kanë shkuar për drekë te miqtë e mi. Kur ne jemi takuar ditën kritike me B.n unë të njëjtin nuk e kam pyetur se me çka ka ardhur dhe pse ka ardhur.

3.1.2. Dëshmitari F. R., gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se ditën kritike pasi që B. ishte ankuar për rastin që i ka ndodhur ish kolegu im A. e ka ftuar të akuzuarin I. në veturën e I., pas kësaj të akuzuarit B. M. dhe I. Sh.kanë ardhur në bankë. Dëshirojë të njoftojë trupin gjykues se meqë ka kaluar një kohë unë nuk jam shumë i sigurit se a e ka ftuar A. ose ish kolegu im tjetër I.. Meqë ishte ditë vikendi unë nuk kam qenë duke punuar në bankë dhe unë kur kam ardhur në bankë B. ishte brenda në bankë së bashku me stafin i cili ka punuar atë ditë. Dita kur ka ndodhur ky rast ka qenë ditë e shtunë. Meqë mua më telefon paraprakisht më kishin njoftuar për rastin që ka ndodh kur unë arrita në bankë e pyeta edhe një herë stafin se çka ka ndodhur. Unë fillimisht iu drejtova B.t, ndërsa ai më tha se fillimisht më kanë sulmuar ku në atë moment unë i besova B.t dhe i thash që të qetësohet. Mandej unë e pyeta se kush e ka sulmuar dhe prej nga kanë ardhur sulmuesit, B. më tha mua se kanë qenë tre veta të cilët kanë zbritur prej shkallëve të hyrjes së ndërtesës në të cilën gjendet banka. Pas kësaj unë kërkova nga B. që të mi dorëzojë të hollat tjera që i kishte me vete në kombi dhe në atë moment dikush nga stafi më tha që B. na ka thënë neve që kanë qenë pesë vetë që e kanë sulmuar. Kjo ishte një indikator i parë që të dyshoja në B.n. Mandej e kam pyetur I. se çka ka ndodhur në këtë rast, ndërsa I. më ka thënë se ka qenë duke ngrënë bukë në veturën zyrtare derisa ka ndodhur ky rast dhe se nuk e ka parë ngjarjen se çka ka ndodhur. Kështu që ne më tej nuk kemi zhvillu biseda me I. Unë kam kërkuar nga të akuzuarit që ti japin deklaratat e tyre në mënyrë të drejtë në mënyrë që të na ndihmojnë për ta zbardhur rastin. Me atë rast unë kam vërejtur se I. nuk e kishte dhënë deklaratën e drejtë se si kishte ndodhur rasti prej kur i kanë pranuar parat e deri kur kanë ardhur në Gj. dhe mund të them se Izahiri ka qenë nën presionin se nuk e ka respektuar procedurën e brendshme të bankës e jo se e ka shkel ligjin. I. e ka pranuar që janë ndal rrugës me B.n, mirëpo nuk më kujtohet nëse kemi biseduar në bankë lidhur me këtë fakt me I.. E di faktin se I. atë ditë nuk ka qenë përgjegjës për bartjen e mjeteve, ngase jam informuar edhe nga Drejtori i bankës në F. se I. është ftuar nga B. ditën kritike vetëm sa për ta respektuar parimin e

“katër syve” për pranim dorëzimit e parave. Pra, ditën kritike nuk ka qenë detyrë e I. që ti bartë të hollat, ngase I. ka qenë sigurim i degës në F..

Detyra e bartjes së mjeteve është një përgjegjësi e veçantë e personave që e kanë patur për obligim ta kryejnë një punë të tillë dhe një detyrë e tillë nuk është dashur t’i besohet çdo punëtori të sigurimit. Në atë kohë dy persona kanë patur autorizim të veçantë për ti bartur mjetet në regjionin e Gj. dhe F. dhe këta dy persona kanë qenë i akuzuari B. dhe një person tjetër që nuk më kujtohet emri. Sipas procedurave të brendshme të bankës punëtori i bankës i cili bënë bartjen e të hollave nuk ka të drejtë që të ndalet në ndonjë restorant për të ngrënë drekë. Gjithashtu, sipas procedurave të brendshme të bankës gjatë pranimi dhe dorëzimit të parave duhet me qenë dy persona në anën e personave që i pranojnë të hollat dhe dy persona tjerë në anën e atyre që i dorëzojnë të hollat.

Edhe herave të më parme kemi patur raste kur vetura e cila ka dorëzuar paratë është ndalur mbrapa bankës, mirëpo ne edhe më parë ia kemi tërhequr vërejtjen të akuzuarit B. që vetura të ndalet para bankës. Unë kam biseduar edhe me oficerë policor pas këtij rasti dhe të njëjtit më kanë thënë se arsyeja pse e kanë përfshirë të akuzuarin I. në këtë rast është deklarata kundërthënëse e tij. Edhe pas bisedës që kam patur me zyrtar policor unë mendoj që I. nuk ka qenë i përfshirë në këtë rast, për shkak se i njëjti në një mënyrë e ka bërë një mosrespektim të procedurave dhe duke dashur që ta fsheh këtë “gaf” i njëjti nuk e ka treguar faktin se gjatë dorëzimit të parave rrugës e ka ndalur veturën për të blerë bukë. Në këtë mënyrë edhe oficerët policor e kanë involvuar vetëm për shkak të faktit se i njëjti nuk e kishte treguar këtë mosrespektim të procedurave.

Unë besoj që këtë vepër kriminale e ka bërë vetëm B., sepse edhe i njëjti ditën kritike e kishte ftuar I. për ta shoqëruar. Të gjitha paratë i janë kthyer bankës dhe nuk kanë qenë të dëmtuara duke përfshirë edhe vulat e sigurisë. Unë edhe në kontakt me policinë kam kërkuar nga ta që ta kenë një lloj mirëkuptimi për I. për shkak të mos përvojës së tij ngase i njëjti në një mënyrë ka qenë edhe viktimë e të akuzuarit B. Gjithashtu, është më rëndësi të theksohet se ditën kritike kur unë kam biseduar me stafin tim të njëjtit më kanë informuar se kur kanë shuar me thirr I., i njëjti nuk kish qenë i informuar fare me ngjarjen që ka ndodhur dhe po flasim për një periudhë të shkurtër kohore. Unë mund të them se duke u bazuar në këto që i cekta më lartë dhe në faktin se ditën kritike kur janë dorëzuar të hollat tek restoranti B. i ka thënë të akuzuarit I. që të blej bukë, I. mendoj që nuk e ka ditur për këtë vepër penale që është duke e kryer B. Pasiqë ka ndodhur ky rast ne i kemi zhvilluar “disa lloj biseda” të brendshme të bankës ku e kam pyetur edhe drejtorin e bankës se çfarë njeriu është Izahiri dhe nga ai jam informuar se Izahiri ka qenë në punëtor i sjellshëm dhe thjesht unë kam marr referenca të mira për të.

Unë jam konsultuar edhe me zyrtarët ligjor të bankës dhe të njëjtit më kanë thënë se meqenëse banka në aspektin material nuk është dëmtuar, atëherë nuk paraqesim kërkesë pasurore juridike. Është e vërtetë se ditën kritike unë e kam parë veturën pasi që veç më kishte njoftuar stafi për rastin që ka ndodh,

vetura kishte qenë mbrapa bankës tek “objekti i ish kadastrit”, më lartë se sa që zakonisht ndalet. Prej vendit ku ka qenë e ndalur vetura ditën kritike nuk mund të shihet vendi ku ka ndodhur inskenimi nga ana e B.t për shkak se koka e veturës ka qenë pak më larg.

### 3.2. Provat materiale

Nga video incizimet e kamerave të bankës shihet vendi ku është inskenuar grabitja nga ana e të akuzuarit, si dhe hapësirat tjera të bankës, kurse nga raporti mjekësor i Emergjencës së Spitalit Regjional në Gj., nr.6739, i datës 08.04.2012, shihet se të akuzuarit B. M., i është ofruar ndihma mjekësore për shkak të lëndimeve të pësuar në kokë.

Nga raporti i shpejtë i Policisë së Kosovës, NJHR-0067-12, i datës 09.04.2012, shihen veprimet të cilat i kanë ndërmarr oficerët, duke filluar nga intervistimi i të akuzuarve; marrja dhe dorëzimi i të hollave zyrtarëve të bankës; etj., kurse nga raporti i vendit të ngjarjes i Policisë së Kosovës, NJHR-0067-12, i datës 09.04.2012, shihet se oficerët policor kanë dalur në vendin e ngjarjes dhe i kanë ndërmarrë veprimet e nevojshme hetimore lidhur me këtë rast.

Nga vërtetimi mbi sendet e sekuestruara, i datës 08.04.2012, shihet nga i akuzuari B. M., është sekuestruar revolja e markës “...”, kalibrit ... mm, me numër serik ..., kurse nga fotografitë që gjenden në shkresa të lëndës shihet vendi ku është inskenuar ngjarja nga ana e të akuzuarit B. M., pastaj shihet hapësira për rreth bankës; vendi ku ka qenë i parkuar furgoni; çanta ku kanë qenë paratë; etj.

Nga formulari i pronës, i datës 08.04.2012, shihet se janë sekuestruar nga oficerët e Policisë së Kosovës paratë të cilat janë të specifikuar nga kartëmonedha prej nga 500 €; 200 €; 100 € dhe 50 €, kurse nga vërtetimi mbi pagesat e gatshme, i datës 07.04.2012, shihet specifikacioni i valutave sipas apoenave.

### 3.3. Deklarata e të akuzuarit I. Sh.

I akuzuari I. Sh., gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se gjatë vitit 2012 kam qenë duke punuar në B. P. të B. në F., në pozitën e punëtorit të sigurimit. Përveç detyrave të mia të sigurimit të objektit, ne kemi patur autorizime që të bëjmë edhe bartjen e parave në mungesë të punëtorëve që kanë qenë të autorizuar për këtë detyrë. Meqë gjatë natës isha në orar të punës të nesërmen me datën ... në ora ... të mëngjesit unë kam qenë në orar të punës dhe në këtë ditë rreth orës . më ka ftuar përmes telefonit B. M. që



të shkoj me të për ta shoqëruar që t'i bart të hollat, ngase punëtori që ka qenë i autorizuar për këtë nuk ka qenë në dispozicion. Kur i njëjti më ka ftuar mua, unë kam qenë në shtëpinë time në pushim ditor. Të autorizuar për bartjen e të hollave kanë qenë B. M. dhe S. M.. Ditën kritike ne jemi nisur prej F. për të shkuar në Han të Elezit dhe unë kam qenë së bashku me B. M. Në H. të E. kemi shkuar me kombi të bankës i cili shërben për bartjen e të hollave. Ne jemi nisur diku rreth orës 13:00 me ç'rast në H. të E. ne kemi arritur dikun rreth orës ... ku kemi marrë një sasi të hollash dhe jemi nisur në drejtim të "...". Derisa ne ishim duke shkuar rrugës për në ..., B. M. ka biseduar me Drejtorin e bankës dhe i ka treguar të njëjtit se ne jemi duke shkuar me I. për ta bërë bartjen e të hollave. Ne pasiqë kemi shkuar në H. të E. jemi kthyer për te "... " duke e shfrytëzuar rrugën K. i v., B., V., Gj. dhe "...". Të hollat që ne i kemi marrë në H. të E. është dashur që të dorëzohen në F.. Tek "... " ne kemi arritur diku rreth orës ..., ku gjatë kësaj kohe unë kam qëndruar në veturë ngase aty ishin të hollat që ne i kishim marrë në H. të E. për ti dorëzuar në F., ndërsa B. M. ka shkuar për t'i marrë të hollat që kanë qenë te "D. i b". Të hollat të cilat ne i kemi marrë tek "Dh. i b." është dashur që të dorëzohen në ... në Gj.. Gjatë rrugës ne jemi ndalur tek Restoran "Planeti" dhe për këtë ishte ide e B. M. t i cili tha që të ndalemi tek restoranti për të marrë bukë. Pasi që ne kemi arritur tek Restorant "...", ne kemi porositë bukë, nuk jemi ulur fare dhe në ato momente B. ka thënë se unë po shkoj t'i kthej paratë se po e ndiej veten të rrezikuar dhe i njëjti më tha se po shkoj për t'i dorëzuar mjetet. Gjatë kësaj kohe unë kam qëndruar në restorant për ta pritur bukën dhe kjo ka mund të zgjasë diku 5 minuta. Vendin ku ka qenë vetura e parkuar unë nuk kam mundur që ta shoh pasiqë ka qenë larg. Pas kësaj B. është kthyer prapë tek restoranti ku më ka thënë se paratë i lash në kerr, pas kësaj ne e kemi marrë bukën dhe jemi kthyer për në Gj.. Gjatë kohës sa kemi qëndruar në restorant unë nuk kam parë ndonjë person që kam mundur ta njoh. Pasi që ne e kemi marrë bukën jemi kthyer në Gj., ku kemi hyrë prapa ... ku gjendet një parkingu dhe aty e kemi ndalur kombin. Prej vendit ku ne e kemi ndalur kombin për të shkuar tek banka është dashur që të depërtohet përmes një korridorit. Vendi ku është ndalur kombi deri te vendi ku është korridori i banesës është diku rreth 10-15 m. Në këto momente B. ka dalur për jashtë, ndërsa unë kam qëndruar në kombi. B. është dal për jashtë gjoja për t'i dorëzuar paratë të cilat ne i kishim marrë tek "Dh. i B.", ndërsa paratë të cilat është dashur t'i dorëzojmë në F. ishin në kombi. Arsyeja pse unë qëndrova në kombi ishte që ti ruaj këto para. Sipas rregullave të bankës nuk është dashur që vetura të ndalet gjatë kohës sa në te gjenden të hollat dhe ditën kritike unë nuk kam patur autorizim me shkrim për ti bartur të hollat. Ne nuk kemi patur ndonjë bisedë tjetër me të akuzuarin B., përveç asaj që i njëjti ka biseduar me drejtorin siç e ceka më lartë. Unë edhe më parë kam shkuar për të bërë bartjen e të hollave dhe atë si përcjellës i të akuzuarit B. Ditën kritike, ne ushqimin e kemi marrë me vete në mënyrë që të njëjtën ta hamë gjatë rrugës. Unë e kam ngrënë ushqimin, ndërsa i akuzuari B. Kur i akuzuari B. ka dalur nga furgoni prapë për të shkuar në ... në Gj. unë nuk kam vërejtur nëse i njëjti ka

marrë diçka me veti. Kur i akuzuari B. më tha se jam sulmuar unë vetëm e pashë se i njëjti e kishte patur të skuqur ballin. Nuk e di se kush e ka ftuar policinë dhe gjithashtu nuk e kam ditur se i akuzuari B. M. ka patur ndonjë armë me veti. I akuzuari B. ka patur pozitë më të lartë se sa unë, ngase i njëjti ka qenë i autorizuar për bartjen e të hollave, kurse unë kam qenë punëtor i sigurimit. Ditën kritike shofer i automjetit ka qenë i akuzuari B. M. dhe arsyeja pse S. M. nuk ka mundur ta shoqëroj B.n është se i njëjti ka qenë i sëmuar.

#### 4. Elementet e veprës penale

Në nenin 422 paragrafi 1 të KPRK, është parashikuar se këtë vepër penale e kryen “Personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t’i shkaktojë dëm personit tjetër ose që seriozisht t’i shkel të drejtat e personit tjetër, ...”. Ndërsa, në nenin 120 paragrafi 2 të KPRK, është parashikuar, se përveç tjerash, shprehja “person zyrtar” nënkupton edhe personin e autorizuar në një organizatë biznesi ose ndonjë person tjetër juridik i cili sipas ligjit apo ndonjë dispozite tjetër të nxjerrë në pajtim me ligj ushtron detyra të posaçme, kurse sipas paragrafit 7 të këtij neni, shprehja “organizatë e biznesit” nënkupton person fizik apo juridik ose grup personash që merren me veprimtari ekonomike.

#### 5. Vlerësimi i provave të adminstruara gjatë shqyrtimit gjyqësor

Trupi gjykues, pas analizimit me shumë kujdes të të gjitha provave të adminstruara gjatë shqyrtimit gjyqësor ka ardhur në përfundim se duhet t’i falet besimi i plotë deklaratës së të akuzuarit I. Sh., i cili e ka mohuar kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet. Kjo për faktin se një mbrojtje e tillë është bindëse, e sinqertë, e logjikshme dhe është në harmoni me provat tjera që janë adminstruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, siç janë deklaratat e dëshmitarëve F. R. dhe L. A., si dhe me provat materiale, siç janë : video incizimet e kamerave të bankës; raporti i shpejtë i Policisë së Kosovës; raporti i vendit të ngjarjes i Policisë së Kosovës dhe fotografitë që gjenden në shkresa të lëndës. Përveç këtyre, deklaratës së të akuzuarit I. Sh., i është falur besimi edhe për shkak të faktit se deklarata e tij është në harmoni edhe me deklaratat e tij të mëparshme të dhënë në cilësi të të pandehurit, ku e përshkruar në mënyrë detaje dhe në mënyrë të njejtë tërë rrjedhën e ngjarjes që ka ndodhur ditën kritike. Dëshmitari L. A., gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se ditën kritike te Restoranti “...” e ka takuar vetëm të akuzuarin B. M., por jo edhe të akuzuarin I.

Sh., përkatësisht ka deklaruar se “nuk e kam parë nëse B. M. ka qenë me ndonjë person tjetër”. Në anën tjetër, dëshmitari F. R., gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimin gjyqësor, siç është cekur edhe më lart, i ka sqaruar në detaje shumë rrethana të cilat shkojnë në favor të mbrojtjes së të akuzuarit I. Sh., e përmes të cilave është argumentuar se i akuzuari I. Sh., nuk e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet dhe as që e ka ditur se i akuzuari B. M., është duke e kryer këtë vepër penale. Dëshmia e dëshmitarit F. R., është vlerësuar si shumë e besueshme, e logjikshme dhe bindëse për trupin gjykues dhe është në harmoni me të gjitha provat tjera të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor. Përveç këtyre, mbrojtja e të akuzuarit I. Sh., gjen mbështetje edhe në fotografitë që gjenden në shkresa të lëndës, nga të cilat shihet se vendi ku është ndalur automjeti ditën kritike ka qenë më larg se sa hyrja që të ka dërguar për në bankë dhe nga ky vend objektivisht nuk ka mundur që të shihet “inskenimi të cilin e ka bërë i akuzuari B. M.”. Në anën tjetër duke i marrë për bazë ato që i ka thënë dëshmitari F. R. për cilësitë personale për të akuzuarin I. Sh. dhe për ngjarjen se si ka ndodhur ditën kritike; se i akuzuari B. M., ka qenë një pozitë më të lartë se sa i akuzuari I. Sh.; etj. trupi gjykues ka ardhur në përfundim se i akuzuari I. Sh., në një mënyrë është manipuluar nga e të akuzuarit B. M. dhe i akuzuari I. as që e ka ditur se i akuzuari B. është duke e kryer këtë vepër penale. Se i akuzuari I. Sh., nuk ka qenë i përfshirë në kryerjen e kësaj vepre penale vërtetohet edhe nga deklaratat e të akuzuarit B. M. të dhënë në procedura të mëparshme, i cili ka deklaruar se për kryerjen e kësaj vepre penale nuk ka ditur i akuzuari I. Sh.. Duke u bazuar në të gjitha këto që u thanë më lart, nga gjitha provat veç e veç dhe të ndërlydhura njëra me tjetrën ka ardhur në përfundim se nuk është provuar se fakti se i akuzuari I. Sh. e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

## 6. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, trupi gjykues e ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

1. se i akuzuari B. M., me dashje dhe me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të dobisë pasuore për vete, e ka kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës ose autoritetit zyrtar, nga neni 422 paragrafi 1 të KPRK në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi.
2. se nuk është provuar se i akuzuari I. Sh., e ka kryer veprën penale neni 422 paragrafi 1 të KPRK, për të cilën është akuzuar sipas aktakuzës së lartcekur.

## 7. Vendimet e trupit gjykues

Andaj, duke u bazuar edhe në gjendjen e vërtetuar faktike pas pranimit të fajësisë, trupi gjykues e ka shpallur fajtor të akuzuarin B. M., për kryerjen e veprës penale të lartcekur, ngase veprimet e të njejtit i përmbajnë të gjitha elementet e kësaj vepre penale dhe se për të njejtën është edhe penalisht përgjegjës.

Ndërsa, meqë nuk është provuar se i akuzuari I. M., e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, trupi gjykues të njejtin e ka liruar nga akuza.

#### 8. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarit B. M., trupi gjykues i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve 73 dhe 74 të KPRK. Në këtë aspekt, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin B. M., trupi gjykues i ka marrë për bazë këto rrethana : se i akuzuari e ka pranuar fajësisë për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet; pendimin e tij për kryerjen e kësaj vepre penale; premtimin e tij se në të ardhmën nuk do të kryejë ndonjë vepër tjetër penale; sjelljet e tij të mira gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor; se sipas deklaratës së të akuzuarit, të cilës trupi gjykues ja fali besimin, i njëjti është i martuar dhe është baba i tre fëmijëve dhe faktin se i njëjti nuk ka qenë i dënuar më parë për ndonjë vepër tjetër penale, gjë që mund të shihet nga shkesa e Gjykatës Themelore në Ferizaj. Gjithashtu, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin B. M., trupi gjykues e ka marrë për bazë edhe faktin se B. P. të B. në Gj., nuk i është shkaktuar ndonjë dëm në kuptimin material, për arsye shuma e të hollave prej 69,700 € i është kthyer kësaj Banke në tërësi.

Kurse, trupi gjykues nuk ka gjetur ndonjë rrethanë rënduese për të akuzuarin B. M..

#### 9. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimeve të shqiptuara

Sipas bindjes së trupit gjykues, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muajve ndaj të akuzuarit B. M., duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit.

Trupi gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim do të mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në

parandalimin e të të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### 10. Vendimi lidhur me paraburgimin

Trupi gjykues, ka vendosur që të akuzuarit B. M., koha e kaluar në paraburgim prej datës ... deri më datën ..., t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

#### 11. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të akuzuarit B. M., trupi gjykues duke u bazuar nën 451 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të akuzuarin ta detyrojë për ta paguar vetëm paushallin gjyqësor në shumë prej 50 Euro.

Kurse, duke u bazuar nën 454, paragrafi 1 të KPP, trupi gjykues ka vendosur që shpenzimet e procedurës sa i përket të akuzuarit I. Sh., paguhet nga mjetet buxhetore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Krimeve të Rënda

Më 23.07.2014

Sekretarja juridike,  
Hyrije Syljmani

Kryetari i trupit gjykues,  
Afrim Shala

**KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve

nga dita e pranimet të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.